

I nderuar z. Oliver Spasovski, Kryetar i Qeverisë së Maqedonisë së Veriut,

I nderuar z. Talat Xhaferi, Kryetar i Kuvendit të Maqedonisë së Veriut,

I nderuar z. Sadulla Duraku, Nënkryetar i Qeverisë së Maqedonisë së Veriut,

Shkëlqesitë Tuaja, përfaqësues të trupit diplomatik,

I nderuar z. Drejtor i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës Shqipe, i dashur Ylber,

Zonja dhe zotërinj të pranishëm,

Akademia e Shkencave e Shqipërisë e priti me shumë kënaqësi ftesën për të marrë pjesë në hapjen dhe punimet e konferencës treditore kushtuar dygjuhësisë, tregjuhësisë, shumëgjuhësisë, këtu në Republikën e Maqedonisë së Veriut, si një dukuri gjithnjë e më sunduese në qytetërimin evropian e botëror dhe për mua është një nder që të përshëndes dhe t'i uroj punë të mbarë konferencës suaj, në ditën e gjuhës amtare.

Kjo konference ka për qëllim të trajtojë sfidat e zbatimit të ligjit të përdorimit të gjuhës në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Zbatimi i çdo ligji, veçanërisht ai i gjuhëve në shtetet multietnike, varet më së pari nga vullneti politik dhe shkalla e emancipimit të shoqërisë.

Prezenca në këtë konference e përfaqësuesve më të lartë të shtetit, dhe vetë arritja e miratimit të këtij ligji flet për mbështetjen që institucionet kryesore i japin zbatimit të tij, e kjo është një garanci suksesi.

Me rajonin tonë shpesh bëhej ironi qoftë kjo edhe nga pikëpamje kulturore neokolonialiste, duke e mbiquajtur Ballkan-babel apo akuzuar se vuan nga kompleksi i mosmarrëveshjeve e keqkuptimeve. Por nuk është më kështu. “Gjuha e tjetrit”, gjuha e fqinjit, siç na e ka shpjeguar mrekullisht Maria Todorova, në librin e saj “Imagining the Balkans”, ka shërbyer ndërkohë edhe si një test emancipimi edhe për rajonin tonë.

Një dijetar i filozofisë klasike të shekullit të 19-të shprehej me kohë se çdo gjuhë është një mundësi më shumë për njeriun, por para së gjithash na duhet gjuha e fqinjit.

Sa më shumë e kuptojmë se nuk bëjmë dot pa njeri tjetrin, aq më qartë e kuptojmë se gjuhët e njëri-tjetrit nuk janë një kufi, por një urë

kulturore e mjet komunikimi, bashkëjetese e bashkëpunimi. Ato nuk duhet të shërbejnë për t'u ndarë por për t'u mirëkuptuar. Evropa e bashkuar, parlamenti Evropian bashkëmin e pranimit në të cilat të dy vendet e popujt tanë i aspirojnë, janë një tregues i qartë i fuqisë bashkuese e komunikuese të popujve të Evropës nëpërmjet pranimit, respektimit e mësimit të gjuhëve të njeri-tjetrit.

Ngritja e statusit të gjuhës shqipe nga pikëpamja juridike, zyrtare dhe intelektuale, e shoqërimi i tyre me institucionet përkatëse ligjzbatuese siç është Agjencia e Zbatimit të Gjuhës Shqipe, është një shenjë e emancipimit dhe e evropianizimit të vetë shtetit e shoqërisë së Maqedonisë së Veriut, dhe ne e çmojmë atë si të tillë.

Në mijëvjeçarin e ri çështja e identitetit është tashmë shumë dimensionale e komplekse.

Identitetet shtetërore shpesh nuk janë paralel me identitetet kombëtare, identitetet kombëtare gjithaq nuk janë paralel me identitetin evropian. Por një gjë është e sigurt: identiteti gjuhësor është ai që mbijeton ndaj çdo faktori tjetër. Ne shqiptarët themi se jemi të tillë, shqiptarë, pse flasim shqip. Prandaj e çmojmë shumë çdo nismë e misionin e Agjencisë për Zbatimin e Gjuhës Shqipe, të kryesuar nga dr. Ylber Sela, për të përballuar sfidat e zbatimit të ligjit për gjuhët, si dhe për të shfrytëzuar të gjitha hapësirat juridike, që ka ofruar kjo situatë e re ligjore në Maqedoninë e Veriut, që folësi i shqipes, pavarësisht nëse është etnikisht shqiptar a maqedonas, të ketë prestigj gjuhësor në të folur e në të shkruar, të ketë dinjitet gjuhësor kur komunikon, të jetë i qytetëruar.

Kjo është arsyeja pse ne kemi vendosur tashmë lidhje të ngushta me Agjencinë me dëshirën e detyrimit për ta mbështetur atë, duke e cilësuar palë të rëndësisë themelore. Kjo konferencë jemi të bindur se do të na tregojë mundësi të reja për të qenë me sukses përkrah njëri-tjetrit.

Përgëzime, i dashur Ylber.

Mbarësi punimeve të konferencës.